



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA  
GJYKATA THEMELORE PRIZREN

---

Numri i lëndës: 2022:093853

Datë: 11.03.2024

Numri i dokumentit: 05432553

C.nr.1559/202

2

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, gjyqtari Uran Zogaj, në çështjen juridike kontestimore të paditësit B.S. nga fshati ..... Komuna e Suharekës, të cilin me autorizim e përfaqëson av. A.Th. nga Prizreni, kundër të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme, P.K.- Drejtoria e Përgjithshme, Prishtinë, me objekt të kontestit kompensimi i pagës së trembëdhjetë dhe shujtave ditore, vlera e kontestit 1,424.56 euro, jashtë shqyrtimit kryesor, më datë 11.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditësit B.S. nga fshati ..... Komuna e Suharekës, kundër të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme, P.K.- Drejtoria e Përgjithshme, Prishtinë.

II. DETYROHET e paditura, që paditësit, në emër të kompensimit të një page mujore (pagesës së trembëdhjetë) t'ia paguaj shumën e përgjithshme prej 649.60 euro për vitin 2021, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga dita e parashtrimit të padisë më datë 12.05.2022 e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.

III. DETYROHET e paditura, që paditësit, t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 134.00 euro, në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.

IV. REFUZOHET e pa bazuar, pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit, përtej shumës së gjykuar sikur në pikën II. të dispozitivit të aktgjykimit deri në shumën e kërkuar prej 1,424.56 euro, përkatësisht shuma prej 75.96 euro në emër të kompensimit të pagës së trembëdhjetë dhe pjesa me të cilën ka kërkuar që të “detyrohet e paditura, që në emër të kompensimit të ushqimit në punë (shujtave) për vitin 2021 të paguajë shumën prej 3 euro për një ditë pune dhe atë për 233 ditë pune, në shumën e përgjithshme prej 699.00 euro, me kamatë ligjore prej 8 % nga dita e arritjes së kërkesës e deri në pagesën përfundimtare”.

A r s y e t i m

Paditësi B.S. nga fshati ..... Komuna e Suharekës, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson av. A.Th. nga Prizreni, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi, kundër të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme, P.K.- Drejtoria e Përgjithshme, Prishtinë, me objekt të kontestit kompensimi i pagës së trembëdhjetë dhe shujtave ditore, vlera e kontestit 1,424.56 euro.

Në padi, pala paditëse ka theksuar se tek e paditura është në marrëdhënie pune me orar të plotë nga data 09.01.2002 dhe merr pagë mujore në lartësi prej 649.60 euro, ndërsa pagën e fundit mujore- pagën e dymbëdhjetë e ka marrë në lartësi prej 725.56 euro. Në bazë të rregullativës ligjore në fuqi, përkatësisht Ligjit të Punës nr.03/L-212, Kontratës Kolektive, Ligjit për Policinë e Kosovës, Udhëzimit Administrativ Nr.04/2017 dhe Nr.02/2018 i datës 14.11.2018, mbi marrëdhënien e punës në Policinë e Kosovës, të njëjtit i takon shpërblimi i një pagë mujore ekuivalente me pagën e rregullt në fund të vitit bazuar në vlerësimet e performancës së punës, si dhe kompensimi i shujtave ditore, gjatë ditëve respektivisht orarit të punës, ku për vitin 2021 ka realizuar gjithsej 233 ditë pune. Andaj nga gjykata ka kërkuar që ta obligoj të paditurën – Ministria e Punëve të Brendshme, Policia e Kosovës- Drejtoria e Përgjithshme, që në emër të kompensimit të pagës së 13-të për vitin 2021, t’ia paguaj shumën në lartësi prej 725.56 euro, si dhe në emër të shujtave ditore shumën prej 699.00 euro, respektivisht shumën e përgjithshme prej 1,424.56 euro, duke llogaritur edhe kamatën ligjore prej 8% nga dita e arritjes së kërkesës e deri në pagesën përfundimtare dhe të detyrohet e paditura që të paguajë shpenzimet e procedurës.

E paditura, në përgjigjen në padi e ka theksuar se nuk e konteston faktin se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura, por e kundërshton në tërësi të pabazuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit. Sa i përket kërkesës për pagën e 13-të dhe shujtave ditore, e ka kundërshtuar pasi që kjo kërkesë nuk është realizuar për asnjë punonjës së Policisë së Kosovës për shkak të mungesës së mjeteve financiare. Po ashtu ka theksuar se e paditura edhe pse ka kërkuar mjete financiare nga Ministria e Financave, e njëjta nuk ka aprovuar kërkesën e Policisë së Kosovës, ashtu që në mungesë së mjeteve buxhetore nuk ka mundur të realizohet pagesa e pagës së 13-të dhe shujtave ditore. Pagesat për shujtat ditore janë realizuar varësisht prej mjeteve buxhetore të aprovuara dhe atë vetëm për një pjesë të zyrtarëve policor që janë të angazhuar në raste të veçanta siç është Njësia Speciale Intervenuese, Njësia Speciale Operative dhe Njësia e Mbrojtjes së Afërt. Andaj, i ka propozuar gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj si të pa bazuar. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 398 dhe 399 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar, andaj pa shqyrtim të çështjes, e aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Ndërmjet palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se paditësi që nga data 09.01.2002, është në marrëdhënie pune pranë të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme, P.K.- Drejtoria e Përgjithshme.

Në këtë drejtim, gjykata përmes vërtetimit të punësimit me numër të referencës 04/1-04-SRR-A/362/2022 të datës 04.04.2022, vërtetoi faktin se paditësi B.S. është i punësuar me orar të plotë në P.K. që nga data 09.01.2002 dhe për punën që e kryen pranë të paditurës merr pagën momentale prej 649.60 euro në muaj. Pastaj, përmes formulari i vlerësimit të performancës për vitin kalendarik 2021, gjykata vërtetoi faktin se paditësi për vitin 2021 ka pasur vlerësim të përgjithshëm, me notën 4.00, që korrespondon me vlerësimin plotësisht i kënaqshëm.

Provat e lartcekura, gjykata i pranoi si provë materiale vendimtare, në kuptim të nenit 329 par. 1 të LPK-së, sipas së cilës dispozitë ligjore përcaktohet se “shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet

apo caktohet në të”. Andaj, meqë këto dokumente janë të pranueshme edhe për vetë palën e paditur, pasi që të njëjtat nuk janë kontestuar, gjykata ia fali besimin e plotë.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Ligjit të Punës Nr.03/L-212, dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-076, për Policinë, si dhe dispozitat e Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018, i datës 14.11.2018, mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, i nënshkruar nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë dhe mendimit juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 213/2023 të datës 09.10.2023.

Në nenin 55 par. 1 të Ligjit të Punës nr.03/L-212 ku përcaktohet se: “i punësuar ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me Kontratën e Punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit”. Në nenin 44 par. 2 të Ligjit nr. 04/L-076, për Policinë, përcaktohet se: “marrëdhënia e punës për personelin policor rregullohet me akt nënligjor”. Ndërsa neni 55 par. 1 nën par. 1.7 i këtij Ligji përcakton se: “Drejtori i Përgjithshëm nxjerr aktet nënligjore për marrëdhënien e punës, siç përshkruhet në paragrafin 2 të nenit 44 të këtij ligji”. Në nenin 5 par. 2 të Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018 i datës 14.11.2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, i nënshkruar nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë, përcaktohet se: “në polici janë të punësuar tri kategori të personelit policor”, ndërsa në pikën 1 të këtij paragrafi parashihet “zyrtarët policor që bëjnë betimin dhe të cilët kanë autoritet t’i ushtrojnë autorizimet dhe detyrat policore”. Ndërkaq në nenin 29 par. 2 të këtij udhëzuesi është paraparë se “personelit të Policisë të cilët kanë marrë vlerësim të kënaqshëm dhe të cilët nuk kanë qenë subjekt i shqiptimit të ndonjë mase disiplinore brenda vitit përkatës, do të përfitojnë si shpërblim një pagë mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit”. Pastaj, sipas pikës II. të mendimit juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 213/2023 të datës 09.10.2023, parashihet se në kontestet nga marrëdhënia e punës- lidhur me kërkesat për shpërblimin e pagës së 13-të, për personelin e policisë, që janë paraqitur pas datës 14.11.2018, në bazë të nenit 29 par. 2 të Udhëzimit Administrativ nr.02/2018 mbi Marrëdhëniet e Punës në Policinë e Kosovës, i cili ka hyrë në fuqi më datë 14.11.2018 dhe në bazë të nenit 30 par. 2 të Udhëzimit Administrativ nr. 01/2021 mbi Marrëdhëniet e Punës në Policinë e Kosovës, i cili ka hyrë në fuqi më datë 29.09.2021, personeli i policisë ka të drejtë në shpërblimin e një page mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit, për vitin 2018, 2019, 2020 dhe 2021.

Në rastin konkret, gjykata gjeti se e paditura ka pasur për detyrim që paditësit si i punësuar pranë saj, t’ia paguaj pagën e 13-të për çdo fund vit, pasi që janë plotësuar edhe kushtet nga ana e paditësit siç parashihen në nenin 29 par. 2 të Udhëzimit Administrativ nr. 02/2018 i datës 14.11.2018, më saktësisht, vlerësimi për vitet 2021 ka qenë plotësisht i kënaqshëm, e po ashtu ndaj të njëjtit nuk është shqiptuar asnjë masë disiplinore.

Gjykata me rastin e vendosjes jashtë seancës gjyqësore, për pjesën aprovuese si në dispozitivin nën I. dhe II. të këtij aktgjykimi është bazuar në nenin 398 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton: “kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”. Në këtë rast, gjykata vlerësoi se në rastin konkret, kërkesëpadia e paditësit për këtë pjesë është qartazi e bazuar.

Ndërsa sa i përket pjesës refuzuese për kërkesën e palës paditëse që në emër të kompensimit të ushqimit në punë (shujtave) të paguajë shumën prej 3.00 euro për një ditë pune dhe atë për 233 ditë pune, në shumën e përgjithshme prej 699.00 euro dhe shumën prej 75.96 euro në emër të

kompensimit të pagës së trembëdhjetë, vendosi jashtë seancës gjyqësore dhe atë në kuptim të nenit 399 par. 1 të LPK-së, pasi që kjo pjesë e kërkesëpadisë së paditësit është e pabazuar në dispozita ligjore dhe prova. Në këtë drejtim, sipas nenit 399 par. 1 të LPK-së parashihet që “kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritore me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”.

Gjykata ka vendosur si në pikën IV. të dispozitivit të këtij aktgjykimi duke refuzuar kërkesëpadinë e paditësit lidhur me kompensimin e shujtave ditore dhe atë për vitin 2021, pasi që paditësi nuk ka arritur që të provoj se me të paditurën si punëdhënës ka raporte kontraktuale ku është përcaktuar detyrimi i të paditurës për paditësin për kompensimin e shujtave ditore. Pretendimi i paditësit, se në neni 29 par. 1 të Udhëzimit Administrativ nr. 02/2018 i datës 14.11.2018, mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës përcakton detyrimin mbi ushqimin gjatë ditëve të punës, gjykata e gjeti si të pa bazuar, pasi që në neni 29 par. 1 të këtij udhëzimi parashihet që “paga bazë, shtesat për rrezikshmërinë në punë, puna jashtë orarit, gjatë festave, shujtë ditore, veshmbathje (për zyrtarët policorë) dhe sigurim shëndetësor për personelin e Policisë duhet të jetë në përputhje me vendin e punës, gradën, kualifikimin dhe përvojën e punës, duke u mbështetur në Ligjin për Policinë, sistemin e pagave dhe shtesave në Polici”. Pra kjo dispozitë përcakton kushtet e përgjithshme të cilave palët kontraktuese, duhet t’iu përmbahen lidhur me të drejtat dhe detyrimet që burojnë nga marrëdhënia e punës, ku kriter për vendosur mbi këto të drejta duhet të jetë vendi i punës, grada, kualifikimi dhe përvoja e punës, duke u mbështetur në Ligjin për Policinë, sistemin e pagave dhe shtesave në Polici, por si dispozitë nuk përcakton në vetvete detyrimin për kompensim, në këtë çështje kontestimore kompensimin për shujta ditore. Gjykata në kuptim të nenit 47 par 4 të Ligjit për Policinë (Ligji Nr. 04/L-076) ku përcaktohet se “pagat themelore dhe çdo shtesë e autorizuar përcaktohet dhe paguhet në përputhje me procedurat e përcaktuara në ligjin në fuqi dhe me aktet nënligjore”, vlerëson se për t’iu njohur e drejta për kompensim në shujta duhet të përcaktohet shprehimisht në Ligj apo në aktet e brendshme nënligjore (që në rastin konkret nuk është përcaktuar shprehimisht me aktet nënligjore të të paditurës, se personelit policor i takon e drejta e kompensimit në shujta ditore). Po ashtu, sipas pikës I. të mendimit juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 213/2023 të datës 09.10.2023, parashihet se në kontestet nga marrëdhënia e punës- lidhur me kërkesat për shpërblimin e shujtës ditore për personelin e policisë, që janë paraqitur pas datës 14.11.2018, nuk aplikohet neni 29 par. 1 i Udhëzimit Administrativ nr.02/2018 mbi Marrëdhëniet e Punës në Policinë e Kosovës, i cili ka hyrë në fuqi më datë 14.11.2018 dhe në bazë të nenit 30 par. 1 të Udhëzimit Administrativ nr. 01/2021 mbi Marrëdhëniet e Punës në Policinë e Kosovës, i cili ka hyrë në fuqi më datë 29.09.2021.

Ndërsa, gjykata ka refuzuar edhe pjesën e kërkesës lidhur me kompensimin e pagës së trembëdhjetë, në shumë prej 75.96 euro, pasi që një kërkesë e tillë nuk kishte mbështetje në provat e dorëzuara nga pala paditëse, përkatësisht provat të cilat i gjeti të bazuara dhe të cilave ua fali fuqinë provuese. Në të vërtetë, deklarata e dhënë nga paditësi Bujar Sahitaj, nuk kishte mbështetje në provat që gjykata ia fali besimin, përkatësisht në vërtetimin me numër të referencës 04/1-04-SRR-A/362/2022 të datës 04.04.2022, si dokument publik. Kështu, deklaratën e paditësit e dhënë më datë 05.04.2022, gjykata e vlerësoi si subjektive dhe të pabazuar. Po ashtu, nga lista e pagave për muajin Dhjetor 2021, rezulton se në pagën e paditësit janë përfshirë edhe kompensimet dhe shtesat tjera. Kësisoj, sipas dispozitave ligjore të theksuara më lartë, paditësi përfiton shpërblimin e një page mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit. Andaj, gjykata gjeti se paga mujore e paditësit është në shumë prej 649.60 euro dhe jo në shumë prej 725.56 euro.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse në emër të pagës së 13-të dhe duke llogaritur kamatën ligjore, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë më datë 12.05.2022, bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Lidhur me kundërshtimet tjera të palës së paditur dhënë në përgjigje në padi, gjykata vlerësoi se të njëjtat nuk janë të bazuara në dispozita ligjore dhe nuk kanë mbështetje në ndonjë bazë faktike apo juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit merititor.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 449, 452 dhe 453 të LPK-së, duke obliguar të paditurën që në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore, paditësit t'ia paguajë shumën e përgjithshme prej 134.00 euro, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, për përpilimin e padisë shumën prej 104 euro dhe për taksë gjyqësore shumën prej 30 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me nenin 398 e 399 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN  
Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil  
C.nr.1559/2022 të datës 11.03.2024

Gjyqta  
ri,  
Uran Zogaj

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit, pranë Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.